



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528

VËRTETIM NËN SHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 7694

Tirane më 01/10/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar



V2024053950469328988



STATUT I SHOQERISE “ALSD” shpk.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 01 / 10 / 2024, ne:

1. **Z. Henri Sadikaj** I biri I Alfred dhe Alketa, shtetas Shqiptar, lindur me 10.10.1996, ne Sarandë dhe banues ne Tiranë, mbajtes i leternjoftimit me nr 033449626 dhe nr Personal J61010071J,

ne përputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm ne Republikën e Shqipërisë, vendosem të miratojme këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 01 / 10 / 2024, ne, themeluesit e mësipërm, themelojme shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar “ALSD” shpk.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: *Objekt ne fushen e ndertimit, duke perfshire por jo kufizuar ne : Studimin , projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve dhe nenkalimeve, autostradave etj. Studim, projektim, ndertim e zbatim te veprave ndertimore te te gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar. Studime urbanistike te te gjitha niveleve, planifikim urban, projektim arkitektonik, projektim linjash dhe sistemesh se prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike, projektim ujesjelles, kanalizime, vepra ujitje,kullimi, projektim topografik . Studime fizibiliteti.Veprimtari ne fushen e transportit te mallrave dhe te udhetareve, lokacione, blerje e tjetersime te pasurive te luajtshme e te paluajtshme. Import, eksport te materialeve dhe pajisjeve te ndryshme . elektromekanike te cdo lloji ne funksion te (digave , hidrocentraleve, nenstacioneve etj) si dhe tregtimin e tyre me shumice dhe pakice brenda dhe jashte vendit, dhenien e asistences teknike per mirembajtjen, riparimin, prodhimin dhe instalimin e pajisjeve dhe te cdo materiali tjeter ndihmes te sistemit dhe rrjetit elektrik. Punime dhe instalime te ndryshme elektrike, mekanike, hidraulike etj. Prodhim, import, eksport, shitblerje tekstiles, veshjesh, uniformash, veshje pune etj. Import, eksport, shitblerjeje, riparim, mirembajtje, automjetesh, mjetesh e pajisjesh te te gjitha llojeve. Administrim, furnizim, mirembajtje, ndertesash, parkimi, ambientesh sportive dhe argetimi, parqe, parqe lojrash dhe cdo ambient tjeter, Import- eksport, shitblerje, instalime, riparime, mirembajtje, te pajisjeve kancelarike, produkte kancelarie, informatike, fotokopje, elektroshtepiake, produkte*

pastrimi, pajisje pastrimi dhe te gjitha llojet e sherbimeve ne lidhje me keto objekte. Sherbimi i pastrimit dhe dezinfektimit. Pastrimi i deteve, lumenjve, liqeneve dhe grumbullimeve ne to. Importim, eksportim, tregtim, mirembajtje, sherbime, te sistemeve te teknologjise se informacionit per perpunimin e te dhenave te te gjitha llojeve si: hardware, software, networking dhe te gjithe periferikeve te tyre si dhe cdo veprimtari tjeter ndihmese. I. Cdo aktivitet tjeter qe lidhet ne menyre direkt dhe indirekt dhe qe i sherben permbushjes se aktiviteteve si me lart. Studime, projektme, zbatim punimesh ne fushen e pyjeve, kullotave, mjedisit, bujqesise, social ekonomike, territorit, infrastruktures etj. Zhvillim, implementim dhe mirembajtje te sistemeve dhe programeve ne fushen e teknologjise se informacionit. Projektim, ndertim dhe mirembajtje ne fushen e telekomunikacionit, sisteme sigurie Web-site etj. Sherbime konsulence dhe trajnime profesionale ne fushen e teknologjise se informacionit dhe telekomunikacionit. Sherbime konsulence, Tregti, eksport-import, furnizime, instalime dhe mirembajtje e pajisjeve elektronike, informatike, audiovizive, te aparturave teknike te telekomunikacionit, te laboratoreve didaktik, kerkimor e shkencore, mallrave industrial. Shitblerje, mirembajtje dhe riparime te pajisjeve dhe materialeve mjekësore etj. Konsulence dhe sherbime te ndryshme per pajisjet spitalore si dhe mirembajtje dhe riparime per keto pajisje. Programim dhe zhvillim te aplikacioneve web- based. Projektim, instalim, mirembajtje i sistemeve te ajrit te kondicionuar, hidrosanitare kunder zjarrit, ngrohjes, ventilimit dhe ftohja. Tregtim i pajisjeve hidrosanitare, kunder zjarrit dhe supervizionit. Importeksport, shumice e pakice i artikujve elektro – industrial si dhe çdo aktivitet ekonomik per pune, mallra , sherbime qe lejohet me ligj sipas procedurave te prokurimit qe shpallen dhe zhvillohen sipas legjislacionit ne fuqi. Cdo aktivitet tjeter qe i lidhe ne menyre direkte apo indirekte dhe qe u sherben aktiviteteve te siperpermendura. Shoqeria mund te hyje ne tregje te ndryshme, te zoteroje pasuri te luajtshme ose te paluajshme si dhe te zoteroje kompani te tjera. Ne funksion te qëllimeve te mësipërme Shoqëria mund te hyje ne tregje dhe operacione te ndryshme, te zotërojë pasuri te luajtshme e te paluajshme dhe/ose pjesëmarrje ne shoqëri te tjera tregtare.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e **pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.**

Neni 4 Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Tirane, Njesia bashkiake nr. 5, Rruga Vaso Pasha, Hyrja 1, Ap. 10, zona kadastrale 8270, pasuria nr. 5/325+1-10

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është ALL 100.00 (njëqind mijë lekë). Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tij të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Henri Sadikaj**: Zotërues i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme ALL 100.000 që përben **100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.**

Kontributi i ortakut te vetëm është në para dhe do të shlyhet prej tij menjëherë me themelimin e shoqërisë.



Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe te shoqëritë kontrolluese dhe/ose te grupit te caktuara me vendimin e Asamblesë. Pjesët e kapitalit mund te kalohen te te tretet vetëm me miratimin e Asamblesë se Përgjithshme, qe jepet nëpërmjet nje vendimi të mare me unanimitet. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërisë qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shperndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një here në vit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve do të thirret nga Administratorët dhe, kur është e zbatueshme, nga Ortaku.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të dërgohet me shkrim apo e-mail në adresat që secili Ortak do t'i njoftojë me shkrim Shoqërisë me poste të regjistruar. Njoftimi do të konsiderohet se i është dorëzuar Shoqërisë me kalimin e ditës së 7-të pas dërgimit.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet të përcaktojë qartë emrin e Shoqërisë, selinë, datën, kohën dhe vendin e mbledhjes, një përshkrim të hollësishëm të procedurës që duhet të ndiqet nga Ortaku për pjesëmarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyrën e marrjes së dokumenteve dhe projekt-vendimeve që duhet të vihen në dispozicion të gjithë Ortakeve, po ashtu edhe rendin e ditës, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve të pakten 7 (shtatë) dite para mbledhjes. Rendi i ditës i njoftuar si më sipër duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve duhet të vendosë për ndryshime të Statutit, teksti përkatës duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

Ortaku mund të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit, përfshirë mjetet e komunikimit elektronik, që garantojnë identifikimin e ortakëve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehin për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër; c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Një Ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakeve nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë i ndryshëm nga Administratorët, duke paraqitur dokumentin përkatës autorizues. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 80 (tetedhjetë) përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi:

- **Z. Henri Sadikaj** I biri I Alfred dhe Alketa, shtetas Shqiptar, lindur me 10.10.1996, në Sarandë dhe banues në Tiranë, mbajtes i leternjoftimit me nr 033449626 dhe nr Personal J61010071J, nr. kontakti: +355682031301 *pa kufizime në kompetencat e administrimit.*

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padi të, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim a mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme: u kthen ortakëve kontributet; u paguan ortakëve interesa apo dividendë; u shpërndan aktivet shoqërisë; lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV Viti financiar-ekspertet

Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjeter dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblese se Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Ne kete rast Ortaku merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaku.

Nëse Ortaku nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaku themelues si vijon:

**ORTAKU THEMELUES
TE SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ALSD" shpk.**

Henri Sadikaj

Henri Sadikaj



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU**



12024053950469328988

**DATE 01/10/2024
NR REP 7694**

“Taksa e P...

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 01.10.2024, para meje Noter JULIAN ZHELEGU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

DEKLARUESI:

Henri Sadikaj, atësia Alfred, amësia Alketa, shtetas Shqiptar, lindur në Sarande dhe banues në Tiranë, me adresë B.Curri; Nd. 076; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 10/10/1996, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033449626 dhe nr. personal J61010071J;

i cili, ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise ne krijim e siper, ka nenshkuar me vullnete të lirë dhe të plotë, dokumentin bashkelidhur Statut i shoqerise “ALSD” Shpk.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

JULIAN ZHELEGU